REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 38117
Datë/Datum. 13.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit: **Korporata Energjetike e Kosovës (KEK).**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - **OSHP Nr.38/17**
Nga:	Basri Fazliu - Ekspert shqyrtues i prokurimit. Zivce Sarkocevic – Ekspert Teknik.		
Lënda:	Ekspertiza për lëndën **"Modernizimi i fushave në Kullën ftohëse Blloku.A4",** me nr. prokurimi: **KEKO-16/114/511.**		
Përgjigjeje në ankesë:	**OE FANS,a.s & N.P.SH ELEKTRONIC Business-PRO, me seli në Çeki.**		
Datë	**13.03.2017**		

Bazuar në nenin 113.1 të LPP-së ju njoftojmë me ekspertizën e lëndës lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Modernizimi i fushave në Kullën ftohëse Blloku.A4",** me nr. prokurimi: **KEKO-16/114/511.",** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Korporata Energjetike e Kosovës (KEK),** dhe me përgjigjeje ndaj ankesës së operatorit ekonomik: OE **FANS,a.s & N.P.SH ELEKTRONIC Business-PRO, me seli në Çeki,** me nr.prot.**38/17**, i datës **08.02.2017**

Konform nenit 113.1, Pjesa IX e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i pavarur, ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

1x1 Panelit Shqyrtues të OSHP-së.
1x1 Autoriteti Kontraktues.
1x1 Operatorit ekonomik ankues.

RAPORTI MBI EKSPERTIZËN E EKSPERTIT SHQYRTUES:

		27.02.2017		28.02.2017		13.03.2017
Nënshkrimi i ekspertit		Data e pranimit të autorizimit		data e fillimit të ekspertizës		data e dorëzimit të raportit të ekspertizës

N. 99, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit.

Me datë: 08.02.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar ankesën me numër të protokollit 38/17, e parashtruar nga operatori ekonomik "FANS,a.s & N.P.SH ELEKTRONIC Business-PRO, me seli në Çeki, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Modernizimi i fushave në Kullën ftohëse Blloku.A4", me nr. prokurimi: KEKO-16/114/511", të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Korporata Energjetike e Kosovës (KEK).

Konform nenit 113.1, Pjesa IX e LPP-së, eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si më poshtë:

N. 111,-Operatori Ekonomik Ankues: FANS,a.s & N.P.SH ELEKTRONIC Business-PRO, me seli në Çeki:

Pikat e Ankesës:
Neni 1 i LPP-së,
Neni 7 i LPP-së,
Neni 59 - i LPP-së
Neni 5 i RRUPP,
Neni 39.4 i RRUPP,
Pika 21.2 e dosjes së tenderit,
Nenin 28 si dhe nenin 31 të Rregullores dhe Udhëzimit për prokurim public.
Neni 11 i RRUPP,

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet:

Kopje e vendimit të AK

Pikat ankimore të operatorit ekonomik ndërlidhen me vazhdimin e vlefshmërisë së ofertës
Gjatë zhvillimit të kësaj procedure të prokurimit disa herë është kërkuar vazhdimi i vlefshmërisë së ofertës dhe është e vërtetë në një rast nuk është kërkuar vazhdimi i vlefshmërisë para datës së skadimit por ka qenë një lëshim i paqëllimshëm dhe në këtë rast operatorët ekonomikë janë trajtuar në mënyrë të barabartë sepse secilit i është dërguar vazhdimi i vlefshmërisë në të njëjtën kohë. Operatorët ekonomikë nuk kanë bërë vërejtje në atë kohë dhe nuk e kanë vazhduar vlefshmërinë e ofertës.

Argumentet tona

Sipas asaj që ne mund të lexojmë në vendimin e AK lidhur me vlefshmërinë e ofertës, AK e pranon

gabimin e saj duke mos bërë kërkesë me shkrim për operatorët ekonomikë para datës së skadimit. Por në anën tjetër AK e arsyeton veten kur thotë se ju keni pranuar kërkesën tonë për vazhdimin e vlefshmërisë së ofertës dhe nuk keni bërë ndonjë vërejtje. *KJO nuk është e vërtetë.*

Dëshmitë:

AK në arsyetimin e vet deklaron se nuk kemi reaguar me kohë lidhur me çështjen e vlefshmërisë së ofertës, e cila ka nxitur reagimet tona sepse, ne kemi reaguar me kohë dhe kemi kërkuar sqarime nga AK, por AK me injorancën më të mundshme nuk ka reaguar fare, ajo çka është edhe më serioze dhe e dëmshme, AK vazhdon të na akuzojë se "Ju nuk keni reaguar ndaj kërkesës tonë për afatin e vlefshmërisë dhe se jeni trajtuar në mënyrë të barabartë me operatorët ekonomikë të tjerë". AK e arsyeton veten se kur kanë shkelur ligjin, në këtë rast duke mos dërguar kërkesë me shkrim për vazhdimin e vlefshmërisë para datës së skadimit, gabimi i tyre është lëshim i paqëllimshëm.

AK e din shumë mirë se pas datës së skadimit e cila ka qenë me 03.10.2016, me 11.10.2016 dhe me 25.10.2016 ne kemi shkruar një e-mail zyrtari i prokurimit përgjegjës për këtë aktivitet të prokurimit dhe CC tek menaxheri i departamentit të prokurimit me 11.10.2016 kemi dërguar reagimin e parë tek AK:

E-mail është i bashkangjitur (shtojca no.3) – Ska përgjigje në pyetjen tonë

Me 25.10.2016 përsëri kemi dërguar një e-mail AK.

E-mail është i bashkangjitur (shtojca no.4) – Përsëri ska përgjigje në pyetjen tonë

Me 07.11.2016 (saktësisht 36 ditë pas datës së skadimit të vlefshmërisë së ofertës) kemi marrë nga AK.

E-mail (kërkesa) me datë 07.11.2016 dërguar nga AK është bashkangjitur (shtojca nr.5)

Duke marrë në konsideratë faktin se nëse nuk i përgjigjemi kërkesës me shkrim të AK, sipas LPP në fuqi, AK ka të drejtë që të refuzojë ofertën tonë nga procedura e mëtejme e prokurimit pa ndonjë arsyetim, ne i jemi përgjigjur këtij e-mail dhe në të njëjtën kohë kemi reaguar në kërkesën e AK dhe kemi pyetur AK nëse kërkesa e tyre ka bazë ligjore sepse vlefshmëria e ofertës ka skaduar me 03.10.2016.

E-mail është i bashkangjitur (shtojca no.6) – Përsëri nuk kemi marrë ndonjë përgjigje/reagim nga AK.

Edhe një arsyetim i yni se AK ka shkelur LPP-në për vlefshmërinë e ofertës është:

Në dosjen e tenderit tek pjesa A; procedurat e tenderimit në seksionin 1, informata për tenderuesit, pika - 21. Vlefshmëria e tenderit është deklaruar qartë:

21.2 në rrethana të jashtëzakonshme, para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit, Autoriteti Kontraktues mund të kërkoj tenderuesve që të vazhdojnë periudhën e vlefshmërisë së tenderit. Kërkesa dhe përgjigjet do të bëhen me shkrim. Nëse sigurimi i tenderit është kërkuar do të vazhdohet për një periudhë korresponduese. Dështimi për të iu përgjigjur kërkesës së bërë nga Autoriteti Kontraktues do të çojë në refuzimin e tenderit pa konfiskim të sigurisë së tenderit.

Në lidhje me këtë pikë në dosjen e tenderit vjen në pyetje, pse këto udhëzime janë të përfshira në dosjen e tenderit, dhe pse OE duhet të respektojnë këto udhëzime dhe jo AK?

Për të qenë të sigurt se ne kemi kuptuar qartë këtë paragraf në dosjen e tenderit, pasi deri me 03.10.2016 ne nuk kemi pranuar ndonjë kërkesë për të vazhduar vlefshmërinë e ofertës, menjëherë pas skadimit të vlefshmërisë së ofertës (e cila ka qenë me 03.10.2016), me 04.10.2016 ne kemi drejtuar një pyetje zyrtare KRPP-së.

E-mail (pyetja) datës 04.10.2016 është e bashkangjitur (shtojca nr.7)

Me 07.10.2016 ne kemi pranuar përgjigje nga KRPP-ja ku qartë është sqaruar se kërkesa për vlefshmërinë e ofertës duhet të jetë dërguar me shkrim para datës së skadimit të vlefshmërisë së ofertës.

E-mail (përgjigja nga KRPP-ja) e datës 07.10.2016 është e bashkangjitur (shtojca nr.8)

Me 07.11.2016 në ditën kur ne kemi pranuar kërkesën nga AK për zgjatjen(vazhdimin) e vlefshmërisë, ne përsëri kemi adresuar edhe një pyetje tjetër KRPP-së për vlefshmërinë e ofertës:

E-mail (pyetja) me datë 07.11.2016 është i bashkangjitur (shtojca nr.9)
Me 08.11.2016 ne kemi pranuar përgjigje nga KRPP-ja dhe edhe njëherë është konfirmuar se AK duhet të dërgojë kërkesë të gjithë OE për vazhdimin e vlefshmërisë së ofertës para datës së skadimit të vlefshmërisë së ofertës.
E-mail (pyetja) me datë 08.11.2016 është i bashkangjitur (shtojca nr.10)

Pra, sipas të gjitha këtyre dëshmive dhe fakteve lidhur me vlefshmërinë e tenderit janë dërguar tashmë tek AK me kërkesën për shqyrtim, AK nuk e ka parë të arsyeshme të pranojë të gjitha dëshmitë, por deklaron se ne kemi pranuar kërkesën e tyre të vonuar për vazhdimin e vlefshmërisë së ofertës – pas datës së skadimit që për AK nuk është asgjë, nuk është kundër ligjit dhe është një lëshim i paqëllimshëm. Në anën tjetër AK po na akuzon neve se nuk kemi reaguar kjo nuk është e vërtetë (dëshmitë tregojnë ndryshe).
Nga 04.10.2016-07.11.2016 ne kemi reaguar dy herë dhe kemi drejtuat pyetje tek AK,por në të kundërten prej nesh AK ka injoruar reagimin tonë dhe nuk ka kthyer përgjigje fare. Gjithashtu me 07.11.2016, kur AK ka dërguar kërkesën për vazhdimin e vlefshmërisë së ofertës dhe kur ne iu kemi përgjigjur atyre me pyetjen kjo kërkesë e tyre a ka bazë ligjore, përsëri me injorancën më të mundshme AK nuk i është përgjigjur e-mail-it tonë.

Prandaj shtrohet pyetja:
PSE AK NUK KA RESPEKTUAR UDHËZIMIN NË DOSJEN E TENDERIT (PIKA 21.2)?
PSE AK NUK KA KTHYER PËRGJIGJE NË REAGIMET TONA TË DATËS 11.10.2016 DHE 25.10.2016?
PSE AK NUK KA KTHYER PËRGJIGJE NË REAGIMIN E DATËS 07.11.2016?

TË GJITHA KËTO FAKTE TREGOJNË SE AK NUK MUND TË ARSYETOJË SHKELJET E LPP-SË, RESPEKTIVISHT AK KA SHKELUR NENIN 28 TË RREGULLORES DHE UDHËZIMIT TË PROKURIMIT PUBLIK QË KA QENË NË FUQI ME 01.11.2016, KA SHKELUR NENIN 31 TË RREGULLORES SË NJËJTË QË ËSHTË NË FUQI NGA 01.11.2016

KONKLUZIONI YNË LIDHUR ME ARSYETIMIN E AK:

Duke marrë parasysh të gjitha këto dëshmi, AK nuk ka bazë ligjore dhe shkelja e LPP-së ka qenë e qëllimshme vetëm për të na detyruar neve të mos i përgjigjemi kërkesës së tyre për vlefshmërinë e tenderi dhe pastaj të refuzoj ofertën tonë pa ndonjë arsyetim, sepse sipas Ligjit, dështimi për tu përgjigjur me kohë, automatikisht do të refuzojë tenderin tonë nga procedurat e mëtutjeshme të prokurimit.

Kopja e vendimit të AK

Pikat ankimore të operatorit ekonomik lidhur me stërzgjatjen e këtij aktiviteti të prokurimit
Lidhur me këtë çështje ju keni marrë përgjigjen e KRPP-së – Departamenti i Monitorimit siç e përmendët në kërkesën për shqyrtim.

Arsyetimi i AK-së me stërzgjatjen e këtij aktiviteti të prokurimit nuk ka kurrfarë lidhje me KRPP-në – Departamenti i Monitorimit. Ne nuk e kuptojmë pse AK e ka arsyetuar veten me stërzgjatjen e aktivitetit të prokurimit me Departamentin e Monitorimit. Qëllimi ynë ka qenë të informojmë AK se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ne kemi dërguar kërkesë tek KRPP-ja Departamenti i Monitorimit për të kontrolluar të gjitha parregullsitë dhe shkeljet e LPP-së. Ne jemi ende duke pritur raportin me shkrim nga ana e Departamentit të Monitorimit.

Konkluzioni ynë:

Pra, AK në këtë arsyetim nuk ka ndonjë bazë ligjore fare dhe AK nuk e ka arsyetuar veten se përse ky proces është i stërzgjatur dhe ne kemi bazë të dyshojmë se pas këtij procesi të stërzgjatur janë fshehur qëllime të paramenduara

Kopja e vendimit të AK

Pikat ankimore të operatorit ekonomik për qasje në dokumente, lidhur me qasjen në dokumente është sqaruar më herët ka pasur keqkuptime dhe duke ua bërë të mundshme qasja për ju është e përgjithshme dhe pa kushte me 19.01.2017 brenda afatit.

Lidhur me këtë arsyetim të AK, ne mund të themi se natyrisht keqkuptimet mund të ndodhin, por mënyra se si kanë ndodhur na bën të dyshojmë se ky keqkuptim ka qenë i qëllimshëm. Kur e themi këtë marrim në konsideratë faktet dhe dëshmitë.
Me 17.01.2017 në 08:08, bazuar në kërkesën tonë për qasje në dokumente, AK e ka caktuar terminin për neve me datën 18.01.2017 në 13:00. Pak para orës një, përfaqësuesit tanë ishin para zyres së prokurimit të AK. U ndaluan nga roja e sigurisë me arsyetimin se ai ka urdhër nga menaxheri i prokurimit se sot askush nuk mund të hyjë brenda zyres së prokurimit për shkak të mbledhjes së rëndësishme që ka stafi i prokurimit. Përfaqësuesit tanë insistuan tek roja se ne kemi termin dhe kërkuam prej tij që të shkojë tek zyrja e prokurimit dhe ti informojë se ne jemi këtu, por ai nuk pranoi për arsye se ai kishte urdhër të rreptë që të mos lejojë askënd brenda zyreve. Përfaqësuesit tanë pritën më shumë se 20 minuta dhe pasi që ishte e pamundur të hyjnë tek zyret sipas terminit të caktuar, pastaj njëri prej përfaqësuesve insistoi që të regjistrohej në librin e mysafirëve si dëshmi qe ne kemi qenë me kohë. Pasi u regjistrua në këtë libër, ai bëri një foto të këtij libri dhe që të dy u kthyen prapa. Në 13:37. Ne kemi marrë telefonatë nga zyrtari i prokurimit përgjegjës me kërkesën se ne mund të kthehemi prap, sepse ka qenë një keqkuptim dhe roja nuk e ka ditur. Por fatkeqësisht ishte vonë sepse përfaqësuesit tanë tashmë ishin larguar. Më vonë në 14:00 kemi pranuar e-mail me arsyetimin për keqkuptimin.
Ne e kuptojmë që keqkuptimet mund të ndodhin çdokujt, por në këtë rast, sjellja e zyrtarit të prokurimit nuk ka qenë profesionale aspak, sepse ai e ka ditur se ne kemi pasur termin dhe ka mundur të na informojë para se të shkonim tek zyret e tyre. Telefonatën e morëm vetëm atëherë kur kuptuan se përfaqësuesi ynë ka fotografuar librin e mysafirëve dhe se ne kemi dëshmi që kemi qenë me kohë sipas terminit të caktuar për ne. Kjo është arsyeja e dyshimit tonë se prap në këtë rast se qëllimi i zyrtarit të prokurimit ka qenë që të na thotë se ne nuk kemi ardhur me kohë sipas terminit dhe se nuk mund të kemi qasje në dokumente sepse nuk e kemi respektuar terminin tonë. Është e vërtetë se pas këtij incidenti ne kemi pasur qasje të pakufizuar në dokumente me 19.01.2017, por kjo ka qenë një ditë pas që do të thotë se ne kemi pasur një ditë më pak për të analizuar të gjitha dokumentet dhe të dërgojmë kërkesën për shqyrtim tek AK.
Fotografia është e bashkangjitur (shtojca nr.11)

Kopja e vendimit të AK
Pikat ankimore lidhur me arsyen e eliminimit
Ne duam të sqarojmë se ju nuk jeni eliminuar për shkak të pikës së përmendur në kërkesën për sqarim por ju jeni eliminuar për shkak të arsyeve tjera. Arsyen e eliminimit e kemi dërguar në njoftimin për eliminim.
Konkluzioni i juaj se komisioni nuk e ka vlerësuar ofertën tuaj në tërësinë e saj dhe është plotësisht e pabazë për arsye se po që se nuk është vlerësuar tërësisht oferta e juaj atëherë nuk do iu dërgohej njoftimi për eliminim me gjashtë pika të eliminimit ku përfshihet pjesa teknike.
Arsyeja përse nuk janë përfshirë fare pikat e eliminimit në raportin vlerësues ka qenë se formulari i

raportit vlerësues lëshuar nga legjislacioni sekondar në ëebfaqen e KRPP-së është e tillë se gjatë plotësimit të raportit vlerësues për secilën kërkesë në fazat e vlerësimit duhet të plotësohet me PO ose JO dhe nëse tek një kërkesë në dosjen e tenderit përgjigja është JO nuk është plotësuar raporti vlerësues në vazhdim për operatorin ekonomik nuk e ka përmbushur kërkesën e dosjes së tenderit dhe në njoftimin për eliminim janë përcjellur të gjitha arsyet e eliminimit

Pretendimi i juaj se oferta e juaj nuk është vlerësuar në tërësi sepse nuk është nënshkruar nga komisioni vlerësues nuk është e vërtetë dhe nuk ka bazë. Asnjë dispozitë e Ligjit të Prokurimit Publik nuk e parasheh se oferta duhet të jetë e nënshkruar nga komisioni vlerësues. AK e ka bërë praktikë që të ofrojë vetëm një nënshkrim.

Formulari i komisionit vlerësues të tenderit është për të parë në cilën datë është vlerësuar oferta. Në këtë rast nuk është bërë lëshim i qëllimshëm i komisionit vlerësues por nuk ndikon në vlerësimin e ofertës.

Lidhur me këtë pikë, ku AK arsyeton vetveten se ne jemi eliminuar vetëm për një arsye, por ka arsye të tjera që janë dërguar neve me njoftimin për eliminim, arsyetimet e AK nuk janë ligjore dhe janë të pabazuara.

Arsyetimi i AK se formulari i raportit vlerësues është i tillë se gjatë plotësimit të raportit vlerësues për secilën kërkesë gjatë fazës duhet të plotësohet me PO ose JO në faqet tjera të raporti vlerësues nuk do të plotësohen për OE që nuk ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit.

Kjo nuk është e vërtetë, sepse është kundër raportit vlerësues që ne kemi marrë nga AK. Është e vërtetë se në secilën faqe të raportit vlerësues gjatë plotësimit të raportit vlerësues për secilën kërkesë të dosjes së tenderit, kur përgjigja JO komisioni vlerësues nuk do të vazhdojë të mbush këtë formular për fazat e mëtejme. Por është një faqe në këtë raport thirret "procesverbali i ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve", në këtë faqe (raporti faqja komisioni vlerësues për secilin OE i cili nuk e ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit, duhet të rendit të gjitha kërkesat që nuk janë plotësuar dhe sipas kësaj duhet të dërgohet njoftimi për eliminim OE. Në këtë faqe e vetmja arsye e eliminimit është:

E ndarë nga letra standarde për eliminim e marrë me 16.01.2017.

Ju nuk keni prezantuar deklaratën e nënshkruar nga të gjithë anëtarët, duke e konfirmuar pjesëmarrjen në grup, dhe se ata do të marrin pjesë në mënyrë individuale dhe/ose grup tjetër në të njëjtën procedurë të prokurimit.

Përsëri kjo nuk është e vërtetë, sepse kjo deklaratë është në dosjen e tenderit. Nëse për komisionin vlerësues nuk ka qenë e qartë çështja lidhur me këtë deklaratë, sipas nenit 59.2 dhe 59.4 të LPP-së dhe neni 39.4 të Rregullores dhe Udhëzuesit të Prokurimit Publik, mund të dërgojë kërkesë me shkrim tek OE për sqarimin e kësaj deklarate. Por komisioni nuk e ka parë të arsyeshme të dërgojë këtë pyetje neve, por në anën tjetër tek OE Ekoinvest&REKO me 09.09.2016 është dërguar një pyetje për sqarime.

Në nenin 39 të Rregullores dhe Udhëzuesit të Prokurimit Publik, është një tabelë me të gjitha dokumentet që kërkohen në dosjen e tenderit, për cilat dokumente mund të bëhen pyetje dhe për cilat jo. Kjo deklaratë është në atë se lejohen sqarime. Duke mos e dërguar kërkesën për sqarime kurse në anën tjetër kjo kërkesë i është dërguar tjetrit pjesëmarrës në tender, AK ka shkelur nenin 7, 59.2, 59.4, 39.4 dhe nenin 1 të LPP-së. Kur themi nenin 7, ne nuk jemi trajtuar në mënyrë të barabartë me OE tjerë dhe jemi diskriminuar. AK nuk e ka respektuar nenin 59.2, 59.4 dhe nenin 39.4 dhe duke mos respektuar nenet në të njëjtën kohë ka bërë shkelje të rëndë të nenit 1 të LPP-së.

ARSYEJA:

duke mos respektuar nenin 59 dhe 39, AK nuk na e ka dhënë mundësinë si kandidat i parë që plotëson kriterin kryesor të dosjes së tenderit që është "Çmimi më i ulët", që të sqarojmë këtë deklaratë por menjëherë na ka eliminuar, dhe ka vazhduar me shkelje duke e dërguar pyetjen për sqarim OE i cili ka ofruar çmimin që është 59,52% më i lartë se çmimi ynë ose është më i lartë se plani i buxhetit për 32%. Është e vërtetë që sipas këtij neni, për AK nuk është obligative – mund- të dërgojë pyetje për sqarim, POR NENI 1 I LPP-SË ËSHTË OBLIGATIV. Duke dërguar pyetje për sqarim ata do të respektonin

nënshkruajë deklaratën duke përdorur formën standarde të aprovuar nga KRPP-ja "deklarata nën betim" duke deklaruar se ai/ajo në mënyrë të sinqertë dhe besnikërisht do të zhvillojë detyrën e vlerësimit në përputhje me LPP-në. Të gjithë anëtarët të komisionit vlerësues marrin përgjegjësinë e plotë individuale për kryerjen e vlerësimit të ofertave në lidhje me vlerësimin teknik të tenderit.
Formularët e dorëzimit të tenderit për gjithë OE që kanë marrë pjesë në këtë tender janë të bashkangjitura (shtojca no.13)

A MUND AK TË SQAROJ, PSE TË GJITHA KËTO LËSHIME TË PAQËLLIMSHME JANË VETËN NË DOSJEN E TENDERIT TONË?

KONKLUZIONI YNË PËR KËTË PIKË:

DUKE MOS E VLERËSUAR TENDERIN TONË SIPAS DISPOZITAVE TË LPP, AK QËLLIMSHËM APO JO QËLLIMSHËM PA NDONJË BAZË LIGJORE, NA LA ELIMINUAR NEVE DHE NE KONSIDEROJMË QË KY FAKT ËSHTË I QËLLIMSHËM DHE PRAPA KËSAJ FSHIHET DIÇKA TJETËR DHE ËSHTË DISKRIMINUESE

Kopja e vendimit të AK

Pikat ankimore në lidhje me buxhetin

Pasi që deri me publikimin e këtij aktiviteti të prokurimit nuk është bërë në zbatimin e projektit të ngjashëm në modernizimin e kullave ftohëse në termocentralet Kosova A dhe B autoriteti kontraktues nuk ka qenë i informuar me vlerën e parashikuar të paisjeve dhe punimet pra janë vetëm inicimi i zotimeve.

KOMENTI YNË

SË PARI: AK arsyetimi lidhur me vlerën e parashikuar të kontratës është qesharak dhe absurd dhe pa ndonjë bazë ligjore. Kur ne themi këtë në të njëjtën kohë pyesim AK, nëse para publikimit të njoftimit për kontratë, AK nuk do të kishte asnjë përvojë për projektet e ngjashme, Pse AK para publikimit të njoftimit për kontratë nuk ka bërë kërkime dhe studime të projekteve të ngjashme dhe pas kërkimeve të detajuara bën një vendim të arsyeshëm lidhur me vlerësimin e paisjeve dhe punimeve që duhet të kryhen në projekt.

Ky arsyetim i AK është i pakuptimtë

SË DYTI: pasi që AK nuk ka qenë në dijeni për vlerën e parashikuar të paisjeve dhe punimeve, në kohën kur është bërë hapja e tenderëve, ka qenë shumë e qartë e dukshme se të gjitha ofertat kanë tejkaluar vlerën e parashikuar të kontratës, e para ka qenë përafërsisht dyfish më e lartë se vlera e parashikuar e kontratës ndërsa e fundit është më e lartë tri herë se vlera e parashikuar. Në këtë rast pasi që gabimi ka qenë gabim i AK duke mos ditur çka të jap si vlerë e parashikuar, pse komisioni vlerësues në fazën e parë të vlerësimit nuk e ka anuluar këtë njoftim për kontratë kjo është një arsye shumë e fuqishme dhe është në përputhje me nenin 62 të LPP – secila ofertë e tejkalon në thelb vlerën e parashikuar, por AK vazhdon me vlerësimin dhe pret përafërsisht 10 muaj për të publikuar njoftimin për dhënie të kontratës me çmimin që tejkalon buxhetin e planifikuar për 320%. Tejkalimi i buxhetit të planifikuar është konfirmuar dy herë nga anëtarët e komisionit vlerësues në faqe 6 dhe 8 të raportit të vlerësimit me datë 14.09.2016.
Me informatën se AK e pati pas hapjes së ditës së tenderit dhe e ka ditur, se cila do të jetë përafërsisht

vlera për kontratë, është shumë herët se gjatë kësaj periudhe , tani më shumë se 10 muaj, AK ka mundur të anuloj këtë aktivitet, ritenderoj atë, vlerësojë dhe përfundojë procedurat e prokurimit për këtë aktivitet të prokurimit në mënyrë transparente duke respektuar LPP dhe mund të përfundohet më pak se 10 muaj. Në këtë rast pretendimi jonë për AK është keqpërdorimi i detyrës zyrtare nga zyrtarët përgjegjës i AK. Prandaj në këtë rast përsëri AK ka shkelur nenin 5 të RRUPP – parashikimi i prokurimit është hapi i parë drejt publikimit të një aktiviteti të prokurimit dhe në të njëjtën kohë AK ka shkelur gjithashtu nenin 11 të kësaj rregulloreje, respektivisht neni 11.1 zyrtari përgjegjes i prokurimit që është përgjegjës për menaxhimin e të gjitha aktiviteteve të prokurimit të AK me juridiksionin e tyre dhe në përputhje me të gjitha dispozitat e LPP. Zyrtari përgjegjes i prokurimit, në përputhje me nenin11.3 është për të nënshkruar kontratën pas rikonfirmimit se informata financiare nuk ka ndryshuar materialisht. Në këtë aktivitet të prokurimit ky nuk është rasti sepse zyrtari përgjegjës i prokurimit, të aprovuar dhe nënshkruar raportin ku është i qartë dukshëm se informata financiare ka ndryshuar në thelb.
Çka është e rëndësishme të përmendet është se në raportin e vlerësimit, pasi që të gjitha procedurat e vlerësimit kanë përfunduar, në faqen 6 komplet lista standarde për radhitjen e tenderëve sipas kriterit të dhënies "Çmimi më i ulët" është një tabelë e quajtur: identifikimi i tenderit të rekomanduar për dhënie të kontratës. Në të njëjtën faqe është një vërejtje e bërë nga anëtarët e komisionit vlerësues. Vërejtja është: komisioni ka bërë vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e të gjithë tenderëve, dhe ka konstatuar se OE Ekoinvest dhe REKA Praha i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit. Komisioni ka konstatuar se ka tejkalim të buxhetit të planifikuar. I mbetet zyrtarit të prokurimi përgjegjës që të aprovoj buxhetin.
Pra sipas kësaj deklarate të komisionit, komisioni nuk ka rekomanduar për dhënie OE, tabela e OE të rekomanduar për dhënie është e zbrazët por në faqen e fundit të këtij raporti me datë 30.12.2016 është një vërejtje e shkruar me dorë.
DUKE PASUR PARASYSH REKOMANDIMIN DHE DEKLARATË TË KOMISIONIT VLERËSUES PROFESIONAL SE GJATË PROCEDURËS TË KËTIJ AKTIVITETI TË PROKURIMIT JANË RESPEKTUAR PLOTËSISHT TË GJITHA DISPOZITAT E LPP-SË, DHE BAZUAR NË DEKLARATËN E DREJTORIT EKZEKUTIV TË TCA Z.HAMDI GASHI ME DATË 20.10.2016 DHE 30.10.2016 DHE DEKLARATËN E DREJTORIT EKZEKUTIV Z. VERDI MURTEZI (PAS PENZIONIMIT TË Z. GASHI) ME DATË 30.12.2016 DHE PAS DEKLARATËS SË DREJTORIT EKZEKUTIV PËR MJETET FINANCIARE NË DISPOZICION TË DATËS 30.12.2016 APROVOJ REKOMANDIMIN E KOMISIONIT.
SIPAS ASAJ ÇKA SHOHIM NË KËTË RAPORT, RAPORTI ËSHTË BËRË NË MËNYRË SHUMË JO PROFESIONALE DHE KREJTËSISHT NË KUNDËRSHTIM ME PLOTË DISPOZITA TË LPP-SË, DHE ZYRTARI PËRGJEGJËS I PROKURIMIT NË APROVIMIN E TIJ DEKLARON SE VLERËSIMI ËSHTË BËRË SIPAS TË GJITHA DISPOZITAVE TË LPP-SË.

Kjo nuk është e vërtetë dhe ne do të vërtetojmë në seancë me dëshmi të fortë duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë dhe deri në përfundim të këtyre procedurave është shkelur LPP-ja, procedurat nuk kanë qenë transparente, të gjitha informatat përkatëse lidhur me këtë aktivitet nuk janë publikuar në mënyrë transparente.

PËR MJETET FINANCIARE NË DISPOZICION TË DATËS 30.12.2016 APROVOJ REKOMANDIMIN E KOMISIONIT.
SIPAS ASAJ ÇKA SHOHIM NË KËTË RAPORT, RAPORTI ËSHTË BËRË NË MËNYRË SHUMË JO PROFESIONALE DHE KREJTËSISHT NË KUNDËRSHTIM ME PLOTË DISPOZITA TË LPP-SË, DHE ZYRTARI PËRGJEGJËS I PROKURIMIT NË APROVIMIN E TIJ DEKLARON SE VLERËSIMI ËSHTË BËRË SIPAS TË GJITHA DISPOZITAVE TË LPP-SË.

Kjo nuk është e vërtetë dhe ne do të vërtetojmë në seancë me dëshmi të fortë duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë dhe deri në përfundim të këtyre procedurave është shkelur LPP-ja, procedurat nuk kanë qenë transparente, të gjitha informatat përkatëse lidhur me këtë aktivitet nuk janë publikuar në mënyrë transparente.

Pikat ankimore lidhur me mos publikimin e njoftimit për dhënie të kontratës pas nënshkrimit të raportit të vlerësimit

Lidhur me pikat ankimore ne sqarojmë se në dosjen e tenderit në nenin 6.4 pika 2 dhe 3 është kërkuar
Një deklaratë e nënshkruar nga Administrata tatimore e vendit tuaj të themelimit se ju nuk jeni shkelës në pagimin e taksave së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit (vetëm për OE i cili do të fitojë kontratën)
Dokument i lëshuar nga Gjykata kompetente e cila konfirmon se operatori ekonomik plotëson "kërkesat e përshtatshmërisë " pika III.1.1.) 2.a, c, d dhe e. – origjinali ose kopja e vërtetuar – kërkohet vetëm për fituesin e tenderit
Pas nënshkrimit të raporti vlerësues nga zyrtari përgjegjës i prokurimit me datë 30.12.2016. Operatori ekonomik i propozuar për kontratë ka qenë dorëzimi i dokumenteve është kërkuar sipas kërkesave të lartë përmendura të dosjes së tenderit. Publikimi i njoftimit për dhënie të kontratës është bërë pas dorëzimit të dokumenteve të kërkuara.

Ne tashmë kemi bërë një kërkesë të AK-së për sqarim, pse AK nuk ka publikuar njoftimin për dhënien e kontratës në pajtim me nenin 22.3.0 të RRUPP. Raporti është nënshkruar nga komisioni me datën 14.09.20116 dhe sipas këtij neni njoftimi për dhënie të kontratës do të duhej të publikohej më së largu me 15 ose 16.09.2016 pas miratimit përfundimtar të zyrtarit përgjegjës të prokurimit me 30.12.2016 pas miratimit të tejkalimit të buxhetit, njoftimi për dhënie të kontratës sipas këtij neni do të duhej me së largu të bëhej me 05.01.2017 (për shkak të festave të fundvitit). Cila ka qenë arsyeja pse AK nuk e ka publikuar këtë njoftim? Përsëri arsyetimi i bërë nga AK është shumë i çuditshëm dhe qesharak. Ne nuk jemi ankuar lidhur me OE të rekomanduar nëse ai ka dorëzuar apo jo këto vërtetime (administrata tatimore dhe vërtetimi nga gjykata). Në faqen e fundit të raportit vlerësues ne shohim se këto vërtetime tanimë janë dorëzuar dhe ne nuk e kuptojmë se cili ka qenë qëllimi i AK për të sqaruar këto vërtetime. Arsyetimi i AK është konfuz, pa bazë ligjore me qfarë arsyetimi AK e mohon vetveten kur përgjigjet se arsyeja për mos publikimin e njoftimit për dhënie të kontratës janë këto dy vërtetime sepse siç thamë më lartë është konfirmuar me 30.12.2016 se këto dokumente janë dorëzuar nga OE. Arsyetimi është e pakuptimtë pasi që AK po tenton të arsyetojë vetveten me arsye të pakuptimta, ka shumë arsye për të dyshuar se madje edhe faqja e fundit e raportit është miratuar ne shpejtësi dhe është plotësuar vetëm atëherë kur AK ka kuptuar se ne kemi bërë kërkesë tek departamenti i Monitorimit me 11.01.2017. vetëm pas kësaj date ata kanë filluar të përgatisin njoftimin për dhënie të kontratës.

Pikat ankimore lidhur me numërimin e ofertës
Lidhur me këtë pikë sqaroni se oferta origjinale është kërkuar vetëm nëse kopja e ofertës e cila nuk është hapur dhe të gjitha autoritetet përkatëse mund të kërkojnë hapjen e ofertës "kopje" për të vërtetuar dokumentacionin e ofertës

KOMENTI YNË

Kemi një pyetje këtu, a mund të dijmë, pse me nenin 32 të RRUPP secili OE që dëshiron të dorësoj tender, të gjitha dokumentet që përbëjnë një tender duhet të jetë i përfunduar dhe numëruar. Dokumentet

e panumëruara në dosjen e tenderit janë një arsye e fortë për të dyshuar se me dokumentet e tenderit mund të manipulohet në çdo kohë dhe një kopje nuk është dëshmi e mjaftueshme, sepse gjatë kësaj periudhe të stërzgjatur të vlerësimit, të gjitha dokumentet mund të ndërrohen (hiqen ose shtohen dokumente shtesë) duke përfshirë këtu edhe kopje gjithashtu. Si mund të besojmë se AK së bashku me OE nuk e ka ndërruar përmbajtjen e dosjes së tenderit (janë gati 10 muaj kohë nga data e hapjes) ky është një arsyetim shumë i pakuptimtë i AK.

Pikat ankimore lidhur me referencat e paraqitura nga OE "Ekoinvest & Reko"

Duke argumentuar se operatori ekonomik i propozuar për kontratë nuk ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me referencë është plotësisht e pabazë, sepse referencat e paraqitura nga EO "EKOINVEST & REKO" kanë plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit.

KOMENTI YNË:
DUHET TË THEMI SE ARSYETIMI I AK LIDHUR ME REFERENCCAT E PARAQITURA JANË TË PA BAZA. AK VETËM PO KONFIRMON POR JO EDHE TË SQAROJ TË KUNDËRTEN E DEKLARATËS TONË SE REFERENCAT E PARAQITURA TË OE "EKOINVEST & REKO" PLOTËSOJNË TË GJITHA KËRKESAT E DOSJES SË TENDERIT;

NE DO TË DOKUMENTOJMË TË KUNDËRTEN
SA I PËRKET DOSJES SË TENDERIT, AK KËRKESA PËR REFERENCË KA QENË:
Së paku dy referenca të realizuara për projektin e ngjashëm në modernizimin e kullave ftohëse në termocentrale me ngarkesë përaférsisht (150 deri në 250 MË) të kryer në tri vitet e fundit. Të dëshmohet me referenca të lëshuara nga punëdhënësi të realizimit me sukses".
Sqarimet tona janë si në vijim:
Ekoinvest & REKO ka mbyllur tri referenca:

1) rregullim i draftit detyruar të kullave të ftohjes nr 3,5 dhe 6 në centralin I Prunérov

Arsyeja e parë se përse kjo referencë nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit është, se centrali Prunerov I ka blloqe prej 110 MW (shihni shtojcën nr.1 – centrali elektrik Prunerov, artikull nga webfaqja zyrtare e ČEZ grup, pronar i centralit elektrik). Nga të lartë përmendurat është e qartë se kulla ftohëse është e ndryshme për secilin bllok, dmth është 110 MË. Arsyeja e dytë është se në konfirmimin e ČEZ e datës 27.04.2016 nuk është specifikuar, se kur janë bërë rindërtimet (shtojca nr.2). Nga webfaqja zyrtare e kompanisë REKO është shkruar qartë se rindërtimi i kullës ftohëse nr. 3 ka qenë me 2000, rindërtimi i kullës nr. 5 ka qenë me 2005, rindërtimi i kullës nr. 6 ka qenë në 2006 (shtojca nr.3) në listën e referencës nga oferta e REKO nuk janë këto rindërtime në listë (shihni shtojcën nr.3a).

Duke pasur parasysh se punimet në ČEZ janë kryer nga REKO nuk janë bërë me 2013, 2014 ose 2015, dhe REKO ka përfshirë këtë referencë për këtë periudhë, kjo nënkupton se këtu është manipulimi me dokumente. Për më tepër në pyetjen drejtuar tek REKO me 09.09.2016 për periudhën kur punimet janë kryer, përgjigja nga REKO është se punimet janë kryer në 2015 kjo nuk është e vërtetë. Mund të shihni nga lista e referencave e REKO për 2013, 2014 dhe 2015 që janë përfshirë në dosjen e tenderit, CEZ nuk është në këto lista dhe ne siç përmendëm më lartë punimet të kryera nga REKO për CEZ janë të periudhës 2000-2006 dhe gjithashtu e konfirmon se centrali elektrik Prunerov është me kapacitet prej 5x250MW dhe 4x100MW por nuk e ka sqaruar se janë dy centrale elektrike Prunerov I dhe Prunerov II (të ngjashme me KEK-un, centrali elektrik Kosova A dhe Kosova B) (shtojca 4)
Ne kemi një pyetje për AK: A ka vërtetuar AK të vërtetën e këtyre dokumenteve që janë dorëzuar nga OE. Nëse PO, atëherë a i kanë kontrolluar këto referenca sepse referenca mund të mos jetë e vërtetë.

2) Dizajnimi, furnizimi dhe ndërtimi i draftit detyruar të kullave të ftohjes për projektin lavaman ngrohjes i fundit tek centrali nuklear Dukovany (nuk është termocentral)

Kjo referencë nuk plotëson kërkesën e dosjes së tenderit, sepse është ndërtim i ri i kullave ftohëse jo modernizim (shtojca nr. 5, 6 dhe 7).

3) Dizajnimi, furnizimi dhe ndërtimi i draftit detyruar të kullave të ftohjes për ENERGETIKA Trinec

Kjo referencë nuk plotëson kërkesën e dosjes së tenderit, sepse është ndërtim i ri i kullave ftohëse jo modernizim (shtojca nr. 8). Kjo referencë nuk plotëson kërkesën e centralit elektrik 150 – 250MW, sepse kjo kullë ftohëse ka prodhimin vetëmm 7,9 MW dhe është për punime hekuri (shih shtojcën nr. 9).

Pika ankimore lidhur me ftohësit e ofruar nga OE "EKOINVEST & Reko"

Duke argumentuar se ftohësit të ofruar nga OE "EKOINVEST & Reko" është plotësisht e pabazuar pasi që OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar ftohësit të kërkesës së dosjes së tenderit

KOMENTI YNË:

NO KOMENT – ËSHTË E PAKUPTUESHME, AK NUK ARSYETON ZGJIDHJE TEKNIKE TË REKO-SË.

SË PARI: zgjidhjet teknike të REKO nuk janë në përputhje me specifikat teknike të dosjes së tenderit sa i përket udhëzimeve që kemi në pjesën A të dosjes së tenderit, pika 3 – specifikimet teknike të obligueshme:

3.1 punimet duhet të përputhen me specifikimet teknike të caktuara në dosjen e tenderit, shih aneksin 1, dhe në përputhje lidhur me vizatimet, sasitë, modelet, mostrat, matjet dhe udhëzimet tjera. Kjo do të demonstrohet me dorëzimin e dëshmive dokumentare të shkruara në FDT.

3.2 Çdo specifikacion që është në mos përputhje me specifikimet teknike do të diskualifikoj tenderin.

Kur themi se zgjidhja teknike e REKO nuk plotëson specifikimet teknike sa i përket aneksit 1, dëshmitë tona janë si në vijim.

REKO në ofertën e tij teknike përshkruan se kulla ftohëse ekzistuese që është e tipit Cross Flow (cilindër) do të transformohet në tipin Counter Flow që është në kundërshtim me specifikat teknike të dosjes së tenderit.

Për më tepër sa i përket njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit në këtë aktivitet të prokurimit variantet nuk lejohen. OE i rekomanduar jo vetëm që nuk e ka ofruar ofertën në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në tender, por ai ka propozuar variante.

Mendimi ynë thelbësor është se modifikimi i tipit prej Cross flow të kullës ftohëse tek tipi Counter Flow nuk është tek modernizimi. Ndërrimi nga Cross Flow tek Counter Flow e kullës ftohëse e përdorur nga kompania REKO nuk është e përshtatshme sepse zvogëlon sipërfaqen e zonës aktive të kullës ftohëse dhe ftohësit të përmendur në ofertën e kompanisë REKO të rrisë humbjen e shtypjes në këtë nivel, ku duhet të ketë ndikim tek performanca e motorrit. Motorri me prodhim prej 75 KW sipas llogaritjeve tona, është i pamjaftueshëm për të arritur parametrat garantuara e ftohjes.

Ne bashkangjesim llogaritjet termike të modernizimit të kullës ftohëse sipas ofertës së REKO (shih shtojcën nr. 10). E cila është përpunuar nga ekspertët tanë, tregon rrjedhjen e ajrit në një celulë 400m3/s. Kjo sasi e ajrit është shumë e lartë për motorrin e 75 KW, e cila do të shkaktojë dështimin e parametrave të garantuara.

Vërejtja jonë e dytë është se mbushjet e ftohësit të përdorura nga REKO (krahasuar me zgjidhen tonë) është shumë e vështirë për trajtimin e ftohjes së ujit dhe për shkak të bllokimit të mbushësve të ftohësve janë shumë të vështirë për mirëmbajtje dhe veprim ne vitet pasuese.

Ndër të tjera duhet të përmendim se çmimi i ofruar i REKO është i mbiçmuar përreth 50-100%.

Ekspertët tanë kanë llogaritur se nëse ndërtojmë një kullë të re e njëjta ecuri në një livadh të gjelbër me jetë për 30-40 vjet, çmimi do të ishte përreth 0.5 milion euro më e ulët se çmimi i REKO modernizimi i kullës ftohëse së vjetër.

III) zgjidhja teknike

Në ofertën e FANS është përmendur dhe mendimi ynë është:

Në kërkim të zgjidhjes së modernizimit të kullave ftohëse ne TPP Kosova FANS s.s shikon tipin ekzistues të kullave ftohëse. Ne besojmë se zgjidhja jonë e propozuar është është zgjidhje optimale dhe e besueshme për Cross Flow kullën ftohëse, dhe kjo zgjidhje është e bazuar në përvojën tonë të gjatë.

Cross Flow kulla ftohëse, e cila është ne TPP Kosova A është dizajnuar për parametra të caktuar dhe sistemi i ftohjes i cili përdoret në sipërfaqen maksimale ftohjes. Nëse përpiqemi të llogarisim dhe duam të përdorim mbushës plastik të ftohësve ne do futemi në disa probleme, të cilat nuk janë konform investimeve tekno-ekonomike.

Siç kemi përmendur në përgjigje të pyetjeve të dërguara lidhur me dosjen e tenderit të datës 29.03.2016. A është obligative përdorimi i mbushësit të ftohësit CHSB 21 ose a mund të përdoret spërkatje apo tipit fletë nga furnizues të tjerë, sipas llogaritjes tonë termoteknike të kullës?

Kjo nuk është obligative por është e nevojshme të plotësohen standardet më të larta të BE-së

Ne kemi vendosur sidomos për shkak të buxhetit të kontratës (800.000 euro) të mbajmë sistemin spërkatës ekzistues, prodhuar nga sistemi i fabrikave që ndër të tjera e përdorur me të madhe në të gjithë botën më gjerë dhe gjithashtu në centralet nukleare. Me këtë sistem kemi zhvilluar llogaritjet termo-teknike që ka qenë e dokumentuar në ofertën tonë.

Zgjidhja jonë – **mbushës i ftohësit spërkatës modern V-BAR,** që është vendosur tek FRB mbështetës + strukturë çeliku e elektrizuar plotëson kushtin për të përmbushur standardet më të larta të BE-së

Ta lësh të pandërruar tipin e mbushësve të ftohësve mbështet eksperti/ prodhues prestigjioz – kompania ENEXIO W Technologies too, bashkangjesim e-mail (shtojca nr.9).

FOTO-nuk kemi munder të bartim.

Për ofertën tonë teknikët FANS kanë përpiluar disa variante dizajnimi të kullës ftohëse me tipet të ndryshme të teknologjisë së përdorur. Opsioni më i mirë në aspektin teknik dhe ekonomik (dmth Shpenzimet e bëra për rindërtim, por edhe veprojnë me kosto vitet pasuese) ne ofruam opsione për përmirësimin e Cross Flow ekzistues kullat e ftohjes me:

- Motorri ngadaltë-shpejtë PMT -90-180 duke përdorur shëndrruesin e frekuencave për kontrollimin e shpejtësisë. Kontrollimi i shpejtësisë performanca e menaxhmentit të kullës së ftohjes, dhe prandaj zvogëlon konsumin.

Motorrët kanë të instaluar motorrin me fuqi prej 90 KË në ofertën tonë. Sipas llogaritjeve tona kërkohet fuqia e boshtit të .... KW tek pika e lakuar dhe 91% efikasitet i motorrit do të jetë1 motorr 74.95 KW.

FOTO-nuk kemi munder të bartim.

Eliminatorët GEA që kanë efikasitet të lartë dhe janë të përshtatshme për këtë lloj Cross Flow kullën ftohëse.

FOTO-nuk kemi munder të bartim.

Mbushës i ftohësit spërkatës modern V-BAR- që është vendosur tek FRB mbështetës + strukturë çeliku e elektrizuar.

V-BAR mbushësit janë projekt i inxhinierëve amerikane për këtë lloj të kullave ftohësve. Materiali FRP është material modern që është përdorur në botë dhe kompania ka vite përvojë me këtë material. Rezistenca dhe qëndrueshmëria e materialit FRP është i lartë. Çeliku i elektrizuar i përshtatet këtij ambienti dhe jeta është më shumë se 25 vite.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit në KRPP-së për kontratë (N.35) :.....04.03.2016
Lloji i procedurës së aplikuar (N.32-35):-.....procedur e hapur
Lloji i kontratës së publikuar(N.16): .....Punë/ vlerë e madhe
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë): 03.05.2016
Data e hapjes së ofertave (N.58):.....03.05.2016-ora 13;30h
Njoftimi për dhënien e kontratës.....16.01.2017
Kriter për dhënien e kontratës..... Tenderi përgjegjshëm, çmimi më i lartë

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike (N.58):

Nr.	Tenderuesi	Vendi	Lote	Çmimi	Vëretje
1	ILAMON	GJERMANI	--	2,490,000.80€	PA TVSH
2	EKOINVEST&REKO PRAHA	PRISHTINË	--	3,357,191.82€	JO
3	I&A	PRISHTINË	--	3,137,620.00€	JO
4	FANS&BUSSINES PRO	PRISHTINË-ÇEKI	--	1,987,777.00€	JO

Në këtë aktivitet të prokurimit kanë marrë pjesë katër (4) operator ekonomik, në procesverbal të hapjes është rexhistruar vërejtje në lidhje me hapjen e ofertave tek OE ILAMON me nr.rendor 1, pasi çmimi i ofruar nga ana e këtij OE është pa TVSH.

Kriteret për kualifikim:

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:
Operatorët ekonomik duhet ti plotësojnë kërkesat minimale te parashtruara

1. Operatori ekonomik duhet te përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të LPP Neni 65.
2. Një vërtetim i nënshkruar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.- kërkohet vetëm për fituesin e tenderit.
3. Një dokument lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e pershtatshmerise" Pika III.1.1.) 2.a,c,d dhe e. – origjinal ose kopje e noterizuar .- kërkohet vetëm për fituesin e tenderit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Një deklarata nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne

dosjen e tenderit. – Origjinal

Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërise, pika 2 dhe 3, do të kërkohen nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit te këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet

III.2.2 Përshtatshmëria profesionale:

1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;
2. Regjistrimi i TVSH;
3. Regjistrimi i numrit fiskal

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e certifikatës së biznesit);
2. Kopja e regjistrimit per TVSH-ne;
3. Kopja e regjistrimit te numrit fiskal.

III.2.3)Kapaciteti ekonomik dhe financiar: N/A

III.2.4)Kapaciteti teknik dhe profesional:

1. Projektet e realizuara brenda 3 viteve te fundit
2. Katalog,mostra, përshkrime, fotografi
3. Përshtatja me specifikat ose standardet .

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Një listë që specifikon secilin nga projektet të kryera nga OE në 3 vitet e fundit .
   Se paku 2 (dy) referenca ne realizimin e projekteve të ngjashme ne moderrnizimet e kullave ftohëse ne termoelektranat e ngarkesave te peraferta (150 deri 250 MW) të përfunduara në 3 vjetët e fundit. Te dëshmohet me reference të lëshuar nga punëdhënësi për kryerjen me sukses te projektit.
2. Përshkrime teknike ose katalogë te prodhuesit për prodhimet që do të liferohen.
3. Kopjet e ISO certifikatave te prodhueseve për prodhimet qe liferohen.

Komisioni vlerësimit pran AK-së:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues (N.80).

Behxhet Maxhuni: Kryesues,
Fatmir Asllani: Anëtar,
Hilmi Hashani; Anëtar,
Naser Grajqevci; Anëtar,
Emin Tmava; Anëtar,

Komisioni vlerësues ka përfunduar punën (raportin e vlerësimit), me datë 14.09.2016, ndërsa Drejtori i ZEP KEK, ka bërë aprovimin e raportit vlerësues me datë 30.12.2016, ku në aprovim të raportit vlerësues citon: se pas deklarimit të DE të TCA, për disponueshmërinë e mjeteve të dt.30.12.2016.

Raporti i komisionit vlerësues:

Komisioni i vlerësimit pas vlerërisimiT ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka konstatuar se OE në konzercium EKO INVEST&REHO PRAHA, i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit. Komisioni ka konstatuar se ka tejkalim substancial të buxhetit të parapar për këtë aktivitet të prokurimit, buxheti i parapar 700,000.00€, prandaj mbetet të vendoset nga e zyrtari përgjegjes i prokurimit në lidhje me buxhetin.

Përgjigjje në pretendimet ankimore nga Ekspertit shqyrtues: (N. 113.1),

Në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të lëndës së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, bazuar në dokumentacionin që kanë pasur në dispozicion eksperti shqyrtues jep mendimin si në vijim:

Eksperti shqyrtues sqaron:
Autoriteti kontraktues gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedur e hapur, kontrat për punë me vlerë të madhe/, kriter për dhënie të kontratës ka qenë: "Tenderi përgjegjshëm çmimi më i ulët". I pakënaqur me njoftimin për dhënien e kontrates , të datës 16.01.2017, për këtë aktivitet të prokurimit, operatoret ekonomik ankues në konzercium OE "FANS&ELEKTRONIC Bussines-PRO", me seli në Çeki, ka parashtruar ankesë fillimisht tek Autoriteti kontraktues KEK, ku i njëjti Autoriteti kontraktues KEK, pastaj me datë 08.02.2017, OE ankues ka parashtruar ankes në OSHP me pretendimet ankimore se janë shkelur neni:

Neni 1 i LPP-së,
Neni 7 i LPP-së,
Neni 59 - i LPP-së
Neni 5 i RRUPP,
Neni 39.4 i RRUPP,
Pika 21.2 e dosjes së tenderit,
Nenin 28 si dhe nenin 31 të Rregullores dhe Udhëzimit për prokurim public.
Neni 11 i RRUPP,

Ekspertja shqyrtues-teknik bazuar në dokumentacioni që ka në shqyrtim si dhe pretendimet ankimore të parashtruar nga OE ankues, vlerësojm si në vijim:

<u>Në lidhje me pretendimin ankimor nr.1</u>
Eksperti shqyrtues vlerëson në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket validitetit të ofertave, Eksperti shqyrtues vlerëson se Autoriteti kontraktues ka bërë vazhdimin e validitetit të ofertave me vones jo konform nenit 31.4 të Udhëzësuesit Operativ për prokurim publik, për në rastin konkret vazhdimi i validitetit është bërë nga OE ankues dhe OE i rekomanduar për kontrat dhe duke u bazuar në këtë dhe në

vendimin e Panelit Shqyrtues të dt.25.11.2014, me nr.prot.884/14, konform pikes II, të këtij vendimi Autoritetet kontraktuese janë të obliguar që të vazhdojnë validitetin e ofertave edhe pas afatit të skadimit të validitetit të ofertave dhe për të njejtën AK-ja NUK mund të anuloj aktivitetin e prokurimit.

Në lidhje me pretendimin ankimor nr.2

Eksperti shqyrtues vlerëson në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket qasjes në dokumentacion zyrtar, në lidhje me nenin 11 të LPP-së,

Në lidhje me këtë Eksperti shqyrtues vlerëson se NUK qëndron pretendimi ankimor për faktin se OE ankues në bazë të shkresave të lëndes ka pasur qasje të pakufizuar në dokumentacionin e ofertës për të cilen ka parashtruar kërkes për qasje ne dokumente zyrtare, konform nenit 11 të LPP-së.

Në lidhje me pretendimin ankimor nr.3

Eksperti shqyrtues vlerëson në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket marveshjes së konzerciumit të OE ankues,

Eksperti shqyrtues vlerëson se NUK qëndron pretendimi ankimor në lidhje me këtë për faktin se OE ankues në konzercium ka ofruar marveshje të konzerciumit por të njejtës i mungon përshkrimi: ***grupi duhet që së bashku me tenderin e tij të dorëzojë një deklarate të nënshkruar nga secili prej anëtarëve, që konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk marrin pjesë në ndonjë grup tjetër që merr pjesë në të njëjtat procedura të prokurimit*** siç parashihet në paragrafin 2 të nenit 71 të LPP-së, citojmë: neni 71.2 i LPP-së: "*grupi duhet që së bashku me tenderin e tij të dorëzojë një deklarate të nënshkruar nga secili prej anëtarëve, që konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk marrin pjesë në ndonjë grup tjetër që merr pjesë në të njëjtat procedura të prokurimit. Të gjitha autoritetet kontraktuese duhet që ta parashtrojë këtë kusht në dosjet e tyre të tenderit. Në rast së një anëtar merr pjesë në disa grupe, secili nga grupet përkatëse do të konsiderohen të papërshtatshëm.*

Në lidhje me pretendimin ankimor nr.4

Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket vonesës të shkaktuar nga ana e Autoritetit kontraktues,

Eksperti shqyrtues vlerëson se qëndron pretendimi ankimor pasi që Autoriteti kontraktues ka bërë një vones në lidhje me vlerësimin e ofertave dhe poashtu në lidhje me zotimin e mjeteve për këtë aktivitet të prokurimit ka tejkaluar shumën e planifikuar, por duke u bazuar në shkresat e lendes Autoriteti kontraktues ka bërë zotimin shtesë te mjeteve për këtë aktivitet të prokurimit me datë 30.12.2016, duke u bazuar edhe në shkresën e zyres së prokurimit z.Isak Kerolli, i cili përshkruan në raportin e vlerësimit se pas deklarates së DP TCA të disponueshmëris së mjeteve të dt.30.12.2016, aprovon raportin e vlerësimit nga ana e komisionit profesionale.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në këtë vlerëson se këto vonesa NUK kanë ndikuar në vendimin final në lidhje me rekomandimin për dhënien e kontrates.

Poashtu eksperti shqyrtues vlerëson në lidhje me arsyetimin e eliminimit sa i përket pretendimit për raportin e vlerësimit dhe letrën standarde, se Autoriteti kontraktues ka paraqitur arsyet e eliminimit në letrën standarde në lidhje me OE ankues, dhe kjo është e mjaftueshme për të kuptuar të arsyet e eliminimit.

Në lidhje me pretendimin ankimor nr.5

Eksperti teknik vlerëson në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket specifikimit teknik të ofruar nga ana e OE të rekomanduar për kontrat në lidhje me ofertën e tij,

Eksperti teknike, vlerëson:

Në dosjen e tenderit AK-ja e ka dhënë qartë që punët duhet të jenë në përputhje të plotë me specifikat teknike të dhëna në dosjen e tenderit (Aneks 1), poashtu duhet bërë modernizimin e paisjeve në përputhje me përshkrimin që përbëhet prej Aneksit 1, (është kërkuar në bazë të

materialit tenderik:elektromotor me fuqi 115KË, nr. i rrotullimeve n=1500, o/min, gjatësia e lopates L=7315mm, nr.lopatave 8, shpejtësia e lopatave n=164 o/min).

Eksperti teknik, me shikin e dosjes teknike të OE të rekomanduar për kontrat qartë shihet se dy operatoret ekonomik fituesi dhe ankuesi, elektromotor me fuqi 90KË të tipit PMH 90-180D, me fuqi P=90/11.3,KË, nr.rrotullimeve n=185/92 o/min, me peshë 2910KG, i cili siguron kapacitetin e qarkullimit të ajrit prej 400m3/sec. (mbushjet e qelizave nga PVC), si dhe eliminuesi i (pikëzimit), që ka ofruar OE i rekomanduar për kontrat janë përputhje me kërkesat për modernizimin e kullave ftohëse. Stërpikësit janë nga plastika që gjithashtu është në përputhje me dokumentacionin teknik (aneks 1).

Eksperti teknik, vlerëson pasi që në kullat e ftohëse ndryshimi i temperatures bëhet me largimin e ngrohtësis, është me rëndësi që të sigurohet shpërndarje sa më e mirë e ujit të ngroht në mënyr që të krijohet sipërfaqja sa më e gjërë prekëse, në mes të ajrit dhe ujit.
Poashtu eliminuesit të pikave (pikëzimit) duhet pamundësuar daljen e pikave të ujit në atmosferë për shkak mbrojtjes së mjedisit jetësorë.

Eksperti teknik, vlerëson se OE i rekomanduar për kontrat i plotëson të gjitha specifikat teknike të parashtruar ne dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontrat.

Eksperti teknik-shqyrtues, në lidhje me arsyetimin e dhënë në letër standarde nga ana e Autoritetit kontraktues sa i përket arsyeve të eliminimit, vlerëon :

Në lidhje me referencat, vlerëson arsyeja e eliminimit, për faktin se OE ankues NUK ka ofruar referenca sipas kërkesës së FDT-së, konkretisht dy referenca të realizuar në 3 vitet e fundit, për faktin se:

referencat e lëshuara nga SLOVNAFT.A.S CLEN SKUPINY MOL e realizuar me 02.08.2012 e cila nuk përmbush kërkesat e dosjes së tenderit (në dosjen e tenderit është kërkuar të jetë për tri vitet e fundit)

Ju keni prezantuar referencat të lëshuara nga HEP- Proizvodnja d.o.o Pogon TE-TO Osijek – Kroaci që është realizuar në periudhën 2014 dhe 2015, por referenca nuk plotëson kriterin e dosjes së tenderit për energjinë e kërkuar të MË, OE ankues ka ofruar referenc me fuqi të përgjithshme 89/139MË, ndërsa është kërkuar me fuqi 150/250MË.

Eksperti teknik, vlerëson NUK ka çertifikat ISO të prodhuesit për produktet që dotë liferoj : electromotor, ventilator, filter të pastrimit, paket ftohëse etj.

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues:

Eksperti shqyrtues-teknik, duke u mbështetur në vlerësimet e lartë cekura, i rekomandon panelit shqyrtues që të APROVOJ si pjesërisht të BAZUAR ankesën OE "FANS&ELEKTRONIK BUSINESS-PRO", me seli në Republika Çeke, për këtë aktivitet të prokurimit dhe njëherit të MBETE në FUQI vendimi i Autoritetit kontraktues "Njoftimi për dhënien e kontratës, i datës 16.01.2017, me titull: "Modernizimi i fushave në Kullën ftohëse Blloku.A4", me nr. prokurimi: KEKO-16/114/511", i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Korporata Energjetike e Kosovës (KEK).